



PNL

NJË SHKOLLË MIQËSORE PËR TË GJITHË

Adresa: Rr. "Sami Frashëri", Tiranë

E-mail: petroninitirane@yahoo.com

Telefoni: 0698625502

Veprimtari të shkollës qendër komunitare
gjatë vitit shkollor
2018-2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

GJIMNAZIT “PETRO NINI LUARASI” TË TIRANËS


TITULLIN “KALORËS I URDHURIT TË FLAMURIT”

“Në shenjë mirënjohjeje me rastin e 60-vjetorit të themelimit, për veprimtarinë e çmuar arsimore, si dhe për edukimin dhe kultivimin e vlerave morale e njerëzore të brezave të rinj, duke i bërë shembull të qytetarisë në shoqëri”.

Nr. Dekreti 11168
Tiranë, më 10.04.2019

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META



Festivali i pakicave etnike në San Caterina Albanez-Cerzeto

Qershor 2019

Qëllimi: Të edukojmë të rinjtë me dashurinë për kulturën dhe traditat e pakicave etnike.

Privilegj që ishim të ftuar në festivalin e pakicave etnike në San Caterina Albaneze / Cerzeto. Në sytë dhe zemrat e arbëreshëve pamë dashurinë që ata ushqenin për Shqipërinë. Arbëreshët janë shembull për të gjithë shqiptarët kudo në botë ,të cilët kanë ruajtur traditat dhe gjuhën shqipe brez pas brezi.



Kujtesa dhe historia mbi Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për shkencën

Kujtesa dhe historia mbi Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri!



Me rastin e 60-vjetorit të shkollës në vijim të nismës “Leksion i hapur” ish-petroninsja Prof. As. Dr. Sonila Boçi Pepivani, në një bashkëbisedim me mësuesit dhe nxënësit e shkollës në kuadër të 9 majit, Ditës së Europës: ” Kujtesa dhe historia mbi Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri”



Ceremonia e dekorimit të shkollës me rastin e 60 vjetorit!

Prill 2019

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për historinë e shkollës

Ceremonia e dekorimit të shkollës me rastin e 60 vjetorit!

Familja e madhe “PETRONINASE”, shënoi “gjurmën” e saj më të thellë! Gjimnazi “Petro Nini Luarasi” u dekorua nga Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta, me titullin: ” Kalorës i Urdhrit të Flamurit ”! Breza të tërë mësuesish e nxënësish, sot, përjetuan emocion të madh, tek dëgjonin vlerësim të jashtëzakonshëm për kontributin e çmuar që kanë dhënë ndër vite!



Kualifikim i brendshëm i mësuesve

Shtator 2018

Qëllimi: Të plotësojmë nevojat e të mësuarit: të rejat e kurrikulës dhe etika në komunikim

Kualifikim i brendshëm i mësuesve

Kualifikimi i brendshëm: Të mësuarit me kompetenca nga doktoresha e shkencave Znj. Aida Goga



Konkurs!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për shkencën

Konkurs!

Me rastin e 140 vjetorit të lindjes së Ajnshtajnit u zhvillua konkursi i fizikës me nxënësit e klasave të 11-ta. E ftuar Drejtore e e fondacionit [Henrietta Leavet](#), mësuesja e fizikës Znj. [Valbona Nathanail](#).



PNL&Special Olympics Albania!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për sportin

PNL&Special Olympics Albania!

PNL& Special Olympics Albania, bashkëpunim që vazhdon nën kujdesin e mësuesit të edukimit fizik I.Fagu.



Grupi i shëndetit të shkollës në aktivitetin për Shëndetin e Zembrës

Shtator 2018

Qëllimi: Krijta e përgjegjesisë së komunitetit për shëndetin, sjelljen e adoleshentëve

Grupi i shëndetit të shkollës Petro Nini Luarasi në aktivitetin për shëndetin e zembrës jep një premtim: Do bëjmë jetë active sport, not, lëvizje me biçikleta dhe do ushqehemi shëndetshëm. Aktiviteti u organizua nga ISHP ASHR me pjesëmarrjen e Ministres së Shëndetësisë, Znj. Ogerta Manastirliu.



Takimi i të rinjve me veteranët!

Tetor 2018

Qëllimi: Të promovojë historinë e popullit tonë

Një grup nxënësish nën kujdesin e mësueses së historisë Fatbardha Hoxha, shkuan tek Shoqata e Veteranëve. Aty, jo vetëm surprizuan të pranishmit, por edhe u surprizuan, pasi u pajisën me certifikata vlerësimi duke u falënderuar për promovimin e historisë së popullit tonë. Kjo ishte një surprizë e bukur për nxënësit!



Fundjava ndryshe!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për sjellje të shëndetshme

Fundjava ndryshe!

Sot gjimnazistët tanë kishin kënaqësinë që të zhvillonin një orë leksioni me përfaqësues të fondacionit “Fundjavë Ndryshe”.

Ky leksion ishte i rëndësishëm dhe i vlefshëm për faktin sepse u diskutua për tema kaq sociale dhe humanitare siç janë vullnetarizmi, puna vullnetare dhe bamirësia.



Për një jetë të shëndetshme pa duhan!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi për shëndetin

Për një jetë të shëndetshme pa duhan!

Duhanpirja shkakton dëmtim të mushkërive, puls dhe rrahje të shpejta zemre, kollitje, sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes, varësi nga nikotina dhe sëmundje tumorale. Personeli mjekësor bashkë me nxënësit e shkollës:

Për një jetë të shëndetshme pa duhan!



Me të rinjtë, për të folur hapur për çështjet e shëndetit mendor, në luftë me stigmën dhe përjashtimin social!

Tetor 2018

Qëllimi: Krijta e përgjegjesisë së komunitetit për shëndetin dhe sportin

Me të rinjtë, për të folur hapur për çështjet e shëndetit mendor, në luftë me stigmën dhe përjashtimin social.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po punon për të ofruar:

Shërbime të integruara, shërbime në komunitet. Me një strategji të qartë drejt decentralizimit dhe deinsti-

tucionalizimit.



Të mbajmë mjedisin pastër!

Tetor 2018

Qëllimi: Të mbajmë mjedisin pastër

Klubi i Gjeografisë nën drejtimin e mësuesit A.Nuriu, me nismën e tyre dolën në pastrimin e territorit të liqenit të Tiranës.



Mediterranean, intercultural!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve

Mediterranean, intercultural!

“Mediterranean, intercultural” për të shkëmbyer eksperiencë mes klasës italiane të Liceo Augusto në Romë dhe gjimnazit tonë, nxënësi Ermbar Beqja na përfaqësoi denjësisht në takim që u mbajt në Romë.



Të edukojmë përgjegjësinë qytetare!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve qytetarë

Të edukojmë përgjegjësinë qytetare!

Në kuadër të ndërgjegjësimit të votuesve për herë të parë në zgjedhjet lokale 2019, me maturat u zhvilluan trajnime dhe situata të stimuluar për votimin. Mësueset e shkencave sociale E.Furriku dhe M.Katundi ndoqën më nga afër e me përkushtim këtë proces.



Vetëkontrolli i gjoksit metoda më e mirë e informimit!

Tetor 2018

Qëllimi: Vetëkontrolli i gjoksit metoda më e mirë e informimit

Biseda dhe demonstrim praktik me vajzat e gjimnazit *Petro Nini Luarasi*.



Aktivitet sensibilizues për programuesit e rinj!

Tetor 2018

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për teknologjinë

Europe Code Week 2018! Nën kujdesin dhe profesionalizmin e Albania ICT Academy dhe mësuesve të TIK-ut, u realizua aktiviteti i radhës në shkollën tonë. Aktivitet në të cilin u nderuam edhe me çertifikatë mirënjohjeje.



Futboll për vajza!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për sportin

Futboll për vajza!

Basketbollit për djem i bashkohet edhe futboli për vajza. Fitues të kupës në kampionatin e minifutbollit për femra që organizohet nga Bashkia e Tiranës.



Dokumentari "Adotto un anciano"!

Maj 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për rëndësinë që ka shërbimi vullnetar


Dokumentari "Adotto un anciano"!

Dokumentari "Adotto un anciano" (Adoptoj një të moshuar) i klubit Alba Junior, të nxënësve që studiojnë gjuhën italiane, solli një pasqyrim të shkurtër të projektit i cili kishte si qëllim edukimin e nxënësve mbi rëndësinë që ka shërbimi vullnetar për moshat e treta. Ky projekt u drejtua nga mësuesja A.Muceku në bashkëpunim me komunitetin e Sant Egidios.

Dokumentari Adotto un anziano (Adoptoj nje te moshuar) i klubit Alba Junior, te nxenesve qe studiojne gjuhen italiane. Nje pasqyrim i shkurter i projektit i cili kishte si qellim edukimin e nxenesve per rendesine qe ka sherbimi vullnetar per moshat e treta. Ky projekt u drejtua nga mesuesja Albana Muceku ne bashkepunim me Komunitetin e Sant Egidios. Ne perfundim nxenesit maturant u pajisen me certificate pjesmarrije te leshuar nga Komuniteti i Sant Egidios

29 May at 19:24 •

Dokumentari Adotto un anziano (Adoptoj nje te moshuar) i klubit Alba Junior, te nxenesve qe studiojne gjuhen italiane. Nje pasqyrim i shkurter i projektit i cili kishte si qellim edukimin e nxenesve per rendesine qe ka sherbimi vullnetar per moshat e treta. Ky projekt u drejtua nga mesuesja Albana Muceku ne bashkepunim me Komunitetin e Sant Egidios. Ne perfundim nxenesit maturant u pajisen me certificate pjesmarrije te leshuar nga Komuniteti i Sant Egidios



Maniela Daula and 56 others • 1 Comment • 2 shares

Send Message



Takimi me bordin dhe komitetin e prindërve!

Tetor 2018

Qëllimi: Grupet e interesit të vlerësojnë burimet e vlefshme në komunitet që lidhen me përbushjen e nevojave të nxënësve në shkollë

Në fillim te vitit shkollor, shkolla ftoi në bashkëpunim, në një takim të gjerë, të gjitha grupet e interesit që lidhen drejtpërdrejt me shkollën, për të vlerësuar nevojat dhe për të hartuar planet afatshkurtra dhe afatmesme. Takime të tilla gjithmonë janë rezultative, pasi merren iniciativa të rëndësishme për nevojat metodiko- pedagogjike dhe infrastrukturore të shkollës. Gjatë kë tij takimi nxënësit u njohën me planin e veprimtarive të klubeve të



Përshkrimi: Urime 1937!

Tetor 2018

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit me shpirtin e letërsisë; Qasja drejt librit dhe leximit

“Urime 1937” erdhi në nder të 80-vjetorit të vdekjes së Migjenit. Falë bashkëpunimit me Iris canaj & Eno Birko nxënësit tanë dhuruan emocion, shpalosën talentet e tyre në interpretim, kërcim, këngë, pikturë dhe IT. Me nxënësit e mrekullueshëm që kemi ia vlen të prekësh skena dinjitoze. Kësaj shfaqje iu shtua dhe prezenca e të mirënjohurës Tinka Kurti.



Sporti edukon shpirtin e garës dhe të lojës në grup!

Maj 2019

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për sportin

Sporti edukon shpirtin e garës dhe të lojës në grup!

Urime mësuesvë I.Fagu dhe R.Omari për garën dhe fitoren e vendit të parë basketboll për djem dhe vendin e dytë volejball për vajza në kampionatin e zhvilluar nën kujdesin e Bashkisë së Tiranës.




Promovim libri!

Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin

Në bibliotekën e shkollës në bashkëpunim me fondacionin "Scard" u zhvillua një takim i ngrohtë e miqësor për promovimin e librit "Miqte e Shpendit". Një kujtesë për figurat dhe heronjtë e kombit tone, një emocion kur shfleton rrugën dhe sakrificat e Skerdilajd Llagamit dhe shokëve të tij në radhët e UÇK-së. Të njohësh historinë e kombit tënd, të vlerësosh kontributin e këtyre heronjve është nevojë dhe detyrim për brezin e ri!



Promovim librash

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin

E kush tha se të rinjtë nuk lexojnë? Petroninsat në promovimin e librave: "Lulet e së keqes", Bodler dhe "Metamorfoza", Franz Kafka me të madhin profesor Primo Shllaku. Libri ndriçon mendjen dhe shpirtin!



Aktivitet me rastin e 74 vjetorit të Çlirimit të Tiranës!

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për historinë e kombit tonë

Një jetë histori! Aktivitet i organizuar nga ekipet lëndore Histori-Gjeografi, Edukimi Fizik dhe Klubi Social.



Java e Tokës 2019!


Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për sjellje të shëndetshme

Java e Tokës 2019!



Në kuadrin e “Javës së Tokës 2019”, klubi i biologëve të shkollës nën drejtimin e kryetares së ekipit lëndor kimi-biologji, mësueses Valbona Karalliu dhe nismës “Green me up” filluan përgatitjet e murit të gjelbër.



Një komb një gjuhë!

Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për arsimin

Një komb një gjuhë!

Si pjesë e programit të shkëmbimit të përvojave midis nxënësve tanë dhe nxënësve nga Kosova në gjimnazin “Petro Nini Luarasi” kemi Oltin, Almën, Doruntinën që jo vetëm ndjekin mësimin, por janë bërë pjesë e aktiviteteve që organizon



shkolla jonë.



Aktivitetet për sensibilizimin e të rinjve për rolin në shoqëri

Nentor 2018

Qëllimi: Të promovojë zërin e të rinjve

“Youth Club” nën drejtimin e mësuses Oriana Osmani, prezantoi sfidat e aktiviteteve në shkollë dhe jashtë saj. Jemi krenarë për petroninsat tanë!



Volejboll!

Nentor 2018

Qëllimi: *Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për shëndetin dhe sportin*

Me të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin në praktimin e sportit. Aktivitet miqësor në volejboll për vajzat mes shkollave “Petro Nini Luarasi” dhe “Sami Frashëri”, organizuar nga mësuesja dhe trajneria ndërkom-bëtare Rudina Omari.



Bulizmi!

Prill 2019

Qëllimi: *Edukimi i të rinjve për sjellje të shëndetshme*

Bulizmi

Një përvojë unike në RTSH, pasi nga nxënësit tanë u trajtua një nga dukuritë më shqetësuese, bulizmi. Kësaj përvojë iu bashkua dhe OLTi, djali nga Kosova, i cili prej disa ditësh, në kuadër të binjakëzimit me shkollat në Kosovë, po mëson pranë gjimnazit tonë.



Tirana Art-Fest!

Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve ma artin

Tirana Art-Fest!

Një performancë e shkëlqyer e nxënësve tanë në konkursin “Tirana Art-Fest”. Nxënësit konkuruan në gjininë e këngës, kërcimit dhe multimedias. Fitues të vendit të parë në këngë e multimedia. Entuziazëm, spektakël, duarttrokitje.

Suksese në takimin e radhës petroninas!



Edukim për Atdheun!

Nentor 2018

Qëllimi: Të edukojmë të rinjtë me dashurinë për atdheun dhe traditat tona

Rroftë kombi shqiptar!

Ne frymëzojmë dhe edukojmë traditën e bukur të shqiptarëve, që çdo i ri dhe e re ta ndiejë brenda çdo rrahje zemre e çdo vlim gjaku se çdo të thotë Shqiptar!



Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës së Gruas!

Nëntor 2018

Qëllimi: Të promovojë zërin e të rinjve

Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës së Gruas!

Youth Club e veshi portokalli Petro Ninin sot, në ditën Ndërkombëtare kundër dhunës së gruas. Të rinj të përkushtuar për të treguar se bota është më e bukur me vajzat! Falënderojmë të gjithë prindërit e pranishëm në këtë event.




Shkëmbim ekperience dhe përvoje!

Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunimin me komunitetin

Shkëmbim ekperience dhe përvoje!

Të premtën më datë 18prill ishte dita e fundit në shkollën tonë e nxënësve nga Kosova. Largohen me përshtypjet më të mira për pritjen dhe ambientin duke e cilësuar shkollën me shumë ngjyra nga brenda dhe jashtë. Çdo ditë e tyre ishte e mirëorganizuar nga DART.




Panairi Ëork & Study!

Prill 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve

Panairi Work & Study!

Në këtë panair morën pjesë nxënës, mësues dhe prindër. Panairi ofron mundësi punësimi dhe studimi brenda dhe jashtë vendit. Panairi Ëork&Study u zhvillua nën kujdesin e DART dhe Bashkisë së qytetit të Tiranës.



Projekti “Plan to include” !

Nëntor 2018

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për sportin

Projekti “Plan to include”, është nisma e fundit e Special Olympics Albania, e cila synon ndërgjegjësimin mbi gjithëpërfshirjen përmes sporteve, për personat me aftësi të kufizuara/ndryshe intelektualë (intellectual disabilities).



Dita Botërore për Përkujtimin e Viktimave nga aksidentet Rrugore!

Nëntor 2018

Qëllimi: Grupet e interesit të vlerësojnë burimet e vlefshme në komunitet që lidhen me përmbushjen e nevojave të nxënësve në shkollë

Fushatë ndërgjegjësimi me gjimnazistët për sigurinë rrugore! Në kuadër të Ditës Botërore për “ Përkujtimin e Viktimave nga Aksidentet Rrugore “, Autoriteti Rrugor Shqiptar së bashku me policinë e shtetit dhe atë rrugore, organizuan një aktivitet sensibilizues me nxënësit e vitit të tretë të shkollës tonë për sigurinë rrugore.



Ceremonia e Diplomimit Matura 2019

Korrik 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për të ardhmen!

!

Per te gjashtin vit radhazi festohet mbyllja e gjimnazit me emociione pafund për prindërit dhe të afërmit e maturantëve. Nga drejtoria e shkollës u shpërndanë certifikata vlerësimi për maturantët më të mirë në arritje në mësim, në art dhe në sport.



Takimi me ish-Petroninsat!

Mars 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunim

Takimi me ish-Petroninsat!

90 minuta leksion jo vetëm teori, por edhe përgjigje fizike të situatave momentale nga ish mësuesja e gjimnazit, znj. Flutura Sheshi. Udhëzime dhe këshilla mjaft të vlefshme... Faleminderit nga të gjithë nxënësit dhe mësueset!



Promovimi i vlerave të klubit social!

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit

Vlerat humanitare të Petroninsave!

Klubi social hapi siparin e veprimtarive të tij. Gjatë këtij aktiviteti u promovuan vlerat dhe u parashikuan idetë dhe veprimat për të ardhmen.



Pasdite letrare !

Nëntor 2018

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin dhe rëndësinë e leximit

Promovimi i romanit "Pika Trëndafil"!

Ky aktivitet u organizua në ambientet e bibliotekës së shkollës me astrofizikanten e njohur Prof. Mimoza Hafizi, për promovimin e romanit shkencor "Pika Trëndafil". Romani u bë pjesë e bibliotekës së shkollës.



Ndiq ëndrrën tënde!

Mars 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve ma artin

Ndiq ëndrrën tënde!



Shfaqje shumë mbreslënëse për të gjithë pjesëmarrësit: aktor dhe shikues. "Ndiq ëndrrën tënde", skenari dhe regjia nga vetë nxënësit, nën drejtimin e mësueses së aktiviteteve Eneida Pema. Faleminderit grupit të aktiviteteve të shkollës për emocionet që përcollët dhe mësuese



Eneidës për përkushtimin dhe këmbënguljen për të krijuar kështu traditën e spaktaklit të pranverës! Urime, jeni më të mirët!



Një lule për ty!

Mars 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunimin me komunitetin

Një lule për ty!

Aktivitet i rrjetit Alba Junior i shkollës tonë. Nxënësit dhuruan dhe mbollën lule për qytetarët e Tiranës si edhe ishin pjesë e promovimit të grumbullimit të baterive.



Promovimi i vlerave të klubit social!

Nëntor 2018

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit

Vlerat humanitare të Petroninsave!

Klubi social në bashkëpunim me organizatën “Të rinjtë për paqen” dhe një grup nxënësish të gjuhës italiane shkuan te shtëpia e të moshuarve. Petroninsat ndanë emocione pozitive me të moshuarit.



Libri ndriçon mendjen dhe shpirtin!

Dhjetor 2018

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin

Promovim librash

Në mjediset e bibliotekës së shkollës, u zhvillua një bisedë letraro-artistike mes shkrimtares, poetes, skenaristes së mirënjohur Natasha Lako dhe maturantëve tanë. Maturantët vlerësuan emancipimin që vjen përmes krijimtarisë letrare sidomos në rastin konkret nga femrat shqiptare.



Fotografia e bukur nuk varet nga aparati, por nga gjetja!

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për historinë e shkollës

“Fotografia e bukur nuk varet nga aparati por nga gjetja”!



Bisedë me fotografimin me famë botërore, Z.Roland Tasho, në përgatitje të ekspozitës me fotografi në kuadër të 60-vjetorit të shkollës. Interesi ishte i madh, “Fotografia e bukur nuk varet nga aparati, por nga gjetja” - kjo ishte porositja kryesore e zotit Roland.



Dija globale, po fati a është global?

Mars 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin

Dija globale, po fati a është global?

19 mars, orë shumë mbreslënëse me profesorin Përparim Kabo për të gjithë pjesëmarrësit: nxënës, mësues dhe ish petroninsa.

Ora iku pa kuptuar dhe nxënësit donin shumë që të dëgjonin këshillat që vinin aq natyrshëm nga profesori, të ndërthurura me përvojën e tij. Lexoni 30 faqe libër çdo ditë!

Porosia e parë dhe mesazhi që

morën: *Dija është globale, por, edhe fati është global!*



Aktivitetet për 1 dhjetorin!

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për sjelljet riskuese

1 dhjetori-Dita kundër Sidës!

Ky aktivitet u organizua nën kujdesin e mësueses Fatbardha Hoxha me nxënëset e klasave të 11-ta.



Aktivitet për sensibilizimin e të rinjve për rolin në shoqëri!

Qëllimi: Të promovojë zërin e të rinjve

Takimi i “Youth Club”

Aktivitet shumë edukativ me prindër dhe nxënës nga mësuese Oriana Osmani. Ishin 10 prindër të profesioneve të ndryshme, të cilët treguan eksperiencat e tyre në shkollë të mesme dhe sot në profesionin e tyre.



Këshillim Karriere!

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për të ardhmen

Këshillim Karriere

Në kuadër të këshillimit të karrierës, i cili ka për qëllim të ndihmojë maturantët të bëjnë zgjedhjen e duhur në orientimin e studimeve, nëpërmjet një video-konference u bë i mundur informimi i maturantëve frankofon, por jo vetëm, mbi programet e studimit që ofron Universiteti INSA- Institut National Des Sciences Appliquees Lyon Francë. Gjejmë rastin të falënderojmë ish petroninsen, Egi Idrizaj, që bëri të mundur këtë bashkëbisedim.



Takimi me ish-Petroninsat!

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve me shkencën

Takimi me ish-Petroninsat!

Në kuadër të 60- vjetorit të gjimnazit tone, në orën e hapur të realizuar nga departamenti i biologji-kimisë, gjimnazistët e vitit të tretë, u njohën më gjerë me disa tema të lëndës së biologjisë, prezantuar plot pasion, seriozitet dhe në mënyrë bashkëkohore nga Prof. Artan Trebicka. Krenarë për brezat!



Aktivitetet për projektet fituese

Dhjetor 2018

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për shkencën

Prezantim projektesh

Në prag të festave të fundvitit u ndane çmimet për projektin fitues në lëndën e matematikës për klasat e 11-ta. Me përgjegjësi dhe përkushtim të gjithë nxënësit ishin angazhuar. Në fund u shpërndanë çertifikata për projektet fituese.



Promovimi i vlerave të klubit social!

Dhjetor 2018

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit

Vlerat humanitare të petroninsave!

Edhe sot në pragfeste, klubi social PNL, i drejtuar nga mësuese Mirela Katundi, shpërndau ndihma për fëmijët në nevojë të njësisë tonë. Me urimin që të ketë mbarësi për të gjithë, humanizmi i nxënësve u kthen buzëqeshjen dhe besimin njerëzve në ditë të mira!!!



Klubi matematikës PNL!

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për shkencën

Klubi matematikës PNL!



Klubi i matematikës realizoi orën me temë: *Vektorët dhe veprime me vektorë në koordinata*. Në funksion të njohurive mbi drejtëzën në plan, shndërrimeve gjeometrike si dhe lëndës së fizikës.



Takimi me ish-Petroninsat!

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunim

Takimi me ish-Petroninsat!



Në kuadër të 60- vjetorit të gjimnazit tone ish mësuesja e frëngjishtes Merita Sauku realizoi një orë mësimi së bashku me mësuesen e frengjishtes, Urani Xheli, me maturantët e frëngjishtes. Kjo nismë sjell në kujtesën e të rinjve sot historikun e

shkollës, kujtime e nostalgji.



Promovimi i vlerave të klubit social

Dhjetor 2018

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit

Krishtlindja në Qendrën e përkujdesjeve të fëmijëve në Kamëz!

Dhurata për fëmijët dhe një ditë e bukur plot dashuri dhe dhembshuri për ta. Klubi Social PNL, pranë tyre në pragfeste data 20 dhjetor



Promovimi i vlerave të klubit social

Dhjetor 2018

Qëllimi: Mbështetja emocionale e nxënësit

Krishtlindja në rrugët e Tiranës!

Krishtlindja në rrugët e Tiranës! U japim buzëqeshje atyre që janë në varfëri! Humanizmi është vlerë e petroninsave! Gëzuar!



Takimi me ish-Petroninsat!

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunim

Takimi me ish-Petroninsat!

Takimi i radhës me dy ishpetroninsat, Prof.Përparim Kabo, matura 1973 dhe Prof.Artan Trebicka, matura 1976. Nostalgji, kujtime për gjimnazin e tyre duke pasuruar historikun. Në këtë takim u vendos që java e parë e tetorit të jetë java e aktiviteteve të 60- vjetorit të shkollës dhe 5 tetori takimi i brezave.



Ardhja e qeverisë së nxënësve të shkollës “Bardhyl Pojani” Pojan, Korçë!

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunimin me komunitetin

Ardhja e qeverisë së nxënësve të shkollës “Bardhyl Pojani” Pojan, Korçë!

11 Shkurt 2019, ardhja e qeverisë së nxënësve të shkollës “Bardhyl Pojani” Pojan, Korçë të shoqëruar nga drejtoresha e tyre dhe mësues të shkollës. U zhvillua një takim shumë miqësor me senatorë të klasave ku u diskutua për aktivitete dhe u shtruan ide për aktivitete të përbashkëta.



Një abetare për diasporën!

Janar 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunimin me komunitetin

Me kontributin e mësuesve dhe nxënësve u realizua nisma “Një abetare për diasporën”! 50 abetare do të dërgohen në shkollën shqipe në Trento, një shkollë e ngritur me kontribut vullnetar, ku mësimi i gjuhës shqipe bëhet në mënyrë vullnetare.



Krijimi dhe menaxhimi i një Ëeb-i!

Janar 2019

Qëllimi: Rritja e përgjegjësisë së komunitetit për teknologjitë e reja

Krijimi dhe menaxhimi i një Ëeb-i!

Ky aktivitet u organizua nën kujdesin e mësuesve të TIK-ut, me nxënës të apasionuar në lëndën TIK. Ëorkshopi u drejtua nga pedagogu i UMB, Z.Marín Nikolli. Nxënësit ishin të interesuar dhe mjaft aktivë.




Pavarësia e Kosovës!

Shkurt 2019

Qëllimi: Të njohim historinë e popullit tonë

Pavarësia e Kosovës!

Me rastin e 11- vjetorit të Pavarësisë së Kosovës si çdo vit, nxënësit të drejtuar nga mësues A. Nuriu, realizuan një aktivitet plot emocione. Të ftuar ishin nxënës, mësues, prindër, administratorja e njesisë nr. 5 Znj.Violeta Kila. E veçanta e këtij aktiviteti që u zhvillua të hënën dt.18.02.2019, ishte prania e zv/ambasadorit të Kosovës, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Atashehut Ushtarak pranë ambasadës së Kosovës në Tiranë .



Sillni një arbëresh në shtëpi!

Shkurt 2019

Qëllimi: Rritja e përgjegjesisë së komunitetit për historinë e popullit tonë!

Sillni një arbëresh në shtëpi!

Aktivitet frymëzues për mësues dhe nxënës nga misionaret e gjuhës arbëreshe, Prof. as. Merita Sauku dhe Prof. Ledi Shamku. “*Sillni një arbëresh në shtëpi, duke lexuar me zë pak nga gjuha e arbërisë çdo darkë...*” - citoi znj. Ledi Shamku. Shkollës iu dhurua vepra “EMIRA”, e autorit A. Santori.



Aktivitet për sensibilizimin e të rinjve sportin!

Qëllimi: Të promovojë sportin e shahut

Kampionati i shahut në shkollë!

Vazhdon tradita e shkollës tonë në zhvillimin e kampionatit të shahut midis klasave paralele. Aktiviteti ishte sa kompetitiv, aq edhe miqësor dhe u zhvillua nga fryma Fair Play. Finalja u zhvillua në një frymë të fortë sportive mes nxënësit Andon Koça dhe Paskal Disho. Kjo ndeshje u fitua nga maturanti Andon Koça për djem dhe Xheni Vrapit për vajza.



Aktivitet bashkëpunimi me komunitetin!

Janar 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për bashkëpunimin me komunitetin

Bashkëpunimi me prindërit është një nga pikat e forta të shkollës sonë. Falënderojmë Z.Artan dhe kompaninë Albalight për ndriçimin *Led* që realizoi rreth e rrotull ndërtesës.



Klubi i librit PNL !

Shkurt 2019

Qëllimi: Edukimi i të rinjve për artin

Klubi i librit PNL!

Një nga arritjet e gjimnazit tonë këtë vit është edhe “Klubi i librit, PNL”. Me emocion të veçantë, sot u përmyll një takim i ngrohtë me publicistin e mirënjohur Ylljet Aliçka. Tregimet e shkurtra të autorit erdhën përmes përshtypjeve të nxënësve të talentuar, të cilët me shumë delikatesë kishin kuptuar ironinë e hollë të autorit për një kohë paradoksale siç që ajo e diktaturës.

